# T-PAGA

Program për menaxhimin e pagave

Moduli i pagave T-Paga është një program me eficence të lartë, i bazuar në rregulla e tregues për llogaritjen e pagës dhe që merr parasysh kërkesat në ndryshim të një organizate me qëllim reduktimin e kostove, të ngarkesës administrative dhe eleminimin e gabimeve në llogaritje.

T-Paga ndihmon në përllogaritjen dhe kontabilizimin automatik të listpagesës. Përllogaritja e pagave në program mund të bëhet në çfardo tip monedhe të konfiguruar paraprakisht. Ndërfaqet dhe formularët e programit të pagave janë dy-gjuhësh: shqip dhe anglisht; për më tepër, programi mund të përdoret më vete, ose të integrohet me softuerë të tjerë.

## Zgjidhje e bazuar në tregues dhe në formulë

Çdo organizatë ka kërkesa specifike të menaxhimit të pagës, ndaj është e nevojshme të përdoret një paketë standarde përllogaritje page që të jetë lehtësisht e konfigurueshme që të marrë parasysh nevojat e veçanta të organizatës. Programi T-Paga të mundëson vlerësimin e kërkesave të biznesit dhe reflektimin e tyre në përllogaritjet e listëpagesës.

Programi T-Paga bazohet në tregues të ndryshëm të pagës, të cilët konfigurohen lehtesisht në sistem, sipas politikës së llogaritjes së pagës së organizatës. Këto tregues mund të ndryshohen në program, duke marr parasysh faktin që kërkesat janë dinamike.

T-Paga mundëson kontroll të plotë mbi formulën dhe rregullat e llogaritjes së pagës. Në këtë mënyrë modelohen rregullat e biznesit. Programi T-Paga, pas konfigurimit dhe pas futjes së të dhënave bazë, kërkon vetëm regjistrimin e të dhënave për pjesemarrjen në punë për çdo punonjës, duke plotësuar treguesit përkatës të pagës. Të gjitha përllogaritjet dhe kontabilizimet do të kryhen në mënyrë të menjëhershme dhe automatike nga programi. Saktësia është siguruar me vlera të parapërcaktuara të sistemit dhe nëpërmjet kushtëzimeve në procesin e punës.

Sistemi përllogarit automatikisht çdo element të pagës dhe gjeneron ndalesat (tatime, sigurime mjeksore dhe shoqërore




detajuar sipas Punëdhënësit dhe Punëmarrësit) sipas legjislacionit në fuqi. Në program, nëse lind nevoja ligjore e ndryshimit të formulave të llogaritjes së ndalesave kryesore të sigurimeve apo tatimeve, ato mund të ndryshohen shpejt dhe lehtësisht. Përdoruesi ka mundësi të përpunojë të dhënat e përllogaritura nëse e mendon të arsyeshme. Pas gjenerimit të listëpagesës, T-Paga realizon në mënyrë automatike kontabilizimin e pagave, duke ndjekur rregullat e kontabilizimit të konfiguruara paraprakisht.

## Disa veçori kyçe

Programi T-Paga vjen si një zgjidhje dinamike dhe eficente për gjenerimin automatik të listëpagesës. Disa nga veçoritë kryesore të tij janë se programi është:

- lehtësisht i konfigurueshëm dhe eficent
- me saktësi të lartë dhe i sigurt
- kryen llogaritje bazuar në tregues të konfigurueshëm në sistem
- formulat e llogaritjes janë lehtësisht të ndryshueshme
- kryen llogaritje automatike të ndalesave si sigurimet shoqërore, shëndetësore, tatime, etj.
- në gjuhën shqipe dhe i konfigurueshëm për çdo monedhë
- kryen kontabilizim automatik të listëpagesës së gjeneruar
- integrohet me sisteme të menaxhimit automatik të kohës

## Na kontaktoni


Kompleksi KIKA 1, Rr. Tish Daia, Pallati Nr.7, kati 2,
1060 Tirana, Albania

info@tetra.al
sales@tetra.al+355 44 508 888
+355 44 508 855


TETRA SOLUTIONS

"Ne mbështetemi në njerëz dhe teknologji".